

Katalogu i veprimit të jashtëm i EUAA-së

Katalogu i veprimit të jashtëm i EUAA-së 2025



Dokumenti u përfundua në nëntor 2025.

Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) dhe personat që veprojnë në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për format e mundshme të përdorimit të informacionit të përfshirë në këtë botim.

Luksemburg: Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, 2025

© Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), 2025

Fotografia / ilustrimi i kopertinës:

Faqja e kopertinës:

Riprodhimi autorizohet me kusht që burimi të citohet. Për përdorimin ose riprodhimin e fotografive apo të materialeve të tjera për të cilat EUAA-ja nuk ka të drejta autori, duhet të merret autorizimi i drejtpërdrejtë i mbajtësit.

Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes	4
Akronimet	5
Hyrje	6
Mandati i EUAA-së në dimensionin e jashtëm.....	6
Përfshirja e shteteve të BE+	7
Objektivat e katalogut.....	8
Struktura e katalogut.....	9
1) Kontributi në forcimin dhe krijimin e legjislacionit, institucioneve dhe sistemeve të azilit, në përputhje me standardet e CEAS dhe të BE-së	11
Zhvillimi dhe/ose harmonizimi i legjislacionit dhe sistemeve të azilit dhe pritjes me CEAS-in.....	12
Koordinimi mes aktorëve të përfshirë në menaxhimin e azilit dhe të pritjes	13
Forcimi i kapacitetit të autoriteteve kombëtare mbi menaxhimin e ndryshimeve për të përmirësuar sistemet e azilit dhe të pritjes	14
Planifikimi i emergjencave	14
Transformimi dixhital	15
Angazhimi ndërkombëtar	16
2) Kontributi në procedurat efikase të azilit	18
Aksesi në mbrojtjen ndërkombëtare	18
Identifikimi, vlerësimi dhe referimi i personave me cenueshmëri dhe/ose nevoja të veçanta	20
Procedurat e specializuara për të miturit e pashoqëruar dhe fëmijët e ndarë	21
Cilësia e procesit të azilit dhe e vendimeve	22
Zhvillimi i kapaciteteve për zyrtarët e kontaktit të parë	23
Zhvillimi i kapaciteteve për nëpunësit e azilit	24
Përmirësimi i të kuptuarit të procedurave të risistemimit	25
3) Kontributi në një sistem efikas pritjeje	26
Harmonizimi i kushteve të pritjes me CEAS-in.....	26
Përmirësimi i menaxhimit të qendrave të pritjes	28
Identifikimi, vlerësimi dhe referimi i cenueshmërive dhe menaxhimi efikas i rasteve në pritje	30
Zhvillimi i kapaciteteve të nëpunësve të pritjes	32



Akronimet

- APD** Direktiva për Procedurat e Azilit
- ARC** Vlerësimi i kushteve të pritjes
- BE** Bashkimi Evropian
- BE+** Shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e asociuara
- CEAS** Sistemi i Përbashkët Evropian i Azilit
- ECS** Strategjia për Bashkëpunimin e Jashtëm
- EUAA** Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin
- FN** Fëmijë të ndarë
- ICS** Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar
- ILF** Interesi më i lartë i fëmijës
- IPC** Identifikimi paraprak i cënueshmërisë
- IPSN** Identifikimi i personave me nevoja të veçanta
- IVO** Informacioni i vendit të origjinës
- KE** Komisioni Evropian
- MV** Monitorimi dhe vlerësimi
- OJQ** Organizata joqeveritare
- PIM** Përcaktimi i interesit më të lartë;
- PSV** Procedura Standarde të Veprimit
- RSF** Qendra për mbështetjen e risistemimit
- SNVA** Vlerësimi i nevojave të veçanta dhe cënueshmërisë
- SOGIESC** Orientimi seksual, identiteti gjinor, shprehja gjinore dhe karakteristikat seksuale
- SHA BE** Shtetet anëtare të BE-së
- TiT** Trajnimi i trajnuesve
- TQNj** Trafikimi i qenieve njerëzore
- UAM** I mituri i pashoqëruar
- UNHCR** Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
- VIM** Vlerësimi i interesit më të lartë
- VT** Viktima të trafikimit





Hyrje

Mandati i EUAA-së në dimensionin e jashtëm

Misioni thelbësor i Agjencisë së Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) është t'u ofrojë mbështetje shteteve anëtare në zbatimin e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS). Gjithashtu, Agjencia po angazhohet gjithnjë e më shumë në kontekstin më të gjerë ndërkombëtar, veçanërisht brenda **dimensionit të jashtëm të CEAS-it**.

Strategjia e re për Bashkëpunimin e Jashtëm e EUAA-së (ECS), e miratuar në mars 2023, përcakton drejtimin e përgjithshëm, objektivat dhe objektin e veprimeve të EUAA-së në dimensionin e jashtëm. Kjo Strategji synon të arrijë objektivat strategjike për zhvillimin e partneriteteve me vendet e treta partnere përmes bashkëpunimit efikas, novator dhe të bazuar në të drejta, si dhe ofron mbështetje të personalizuar, duke përdorur ekspertizën, mjetet dhe praktikatat më të mira të EUAA-së dhe shteteve të BE+.

ECS-ja prezantoi një ndryshim të rëndësishëm, siç ishte kalimi nga identifikimi i prioritetëve fikse gjeografike, i parashikuar në strategjinë e mëparshme, drejt një **qasjeje** më dinamike **e cila vendos në qendër marrëdhëniet**. Kjo qasje kërkon që, në veprimin e saj të jashtëm, EUAA t'u japë përparësi shteteve kandidate dhe shteteve aspirante për kandidate të cilat kërkojnë të përmbushin objektivat e tyre të anëtarësimit në BE, pasuar nga shtetet e tjera të Fqinjësisë Evropiane dhe në fund, nga shtetet jashtë Fqinjësisë (referuar në këtë dokument si shtetet "përgjatë gjithë itinerarit të migrimit ("whole-of-route" countries)").

Kjo qasje synon të garantojë fleksibilitet më të gjerë për ta lejuar Agjencinë që t'u përgjigjet nevojave të ndryshueshme në dimensionin e jashtëm, brenda kufijve të burimeve të veta dhe duke bërë një shpërndarje burimesh që është proporcionale me nivelin e prioritetit që i jepet shtetit/rajonit në fjalë.

Brenda EUAA-së, **Spektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar (ICS)** është përgjegjës për koordinimin e sigurimit të mbështetjes ndaj vendeve të treta partnere. Si rezultat i ekspertizës dhe njohurive mbi kontekstet e vendeve të treta partnere, gjë që shton vlerë në hartimin dhe zbatimin e nismave të zhvillimit të kapaciteteve përtej kufijve të Bashkimit Evropian, ICS-ja bashkëpunon ngushtësisht me sektorët dhe qendrat përkatëse brenda EUAA-së. Ndërsa BE-ja zgjeron angazhimin e saj në dimensionin e jashtëm të CEAS-it, EUAA-ja bëhet instrumentale në nxitjen e dialogut, koordinimin e përpjekjeve dhe personalizimin e veprimeve mbështetëse për shqyrtimin e nevojave të vendeve të treta partnere.

Agjencia mund të ofrojë një **grup** gjithëpërfshirës **instrumentesh bashkëpunimi** për zbatimin e aktiviteteve në vendet e treta. Këtu përfshihen udhërrëfyesit dypalësh për bashkëpunimin, shoqëruar nga nismat rajonale¹ për të trajtuar nevojat e përbashkëta, si dhe për të lehtësuar dhe

¹ Mbështetur nga projekte të ndryshme, si p.sh. Mbështetja Rajonale e BE-së kundrejt Sistemeve të Menaxhimit të Migracionit Sensitiv ndaj Mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor dhe projekti pilot rajonal për Afrikën e Veriut dhe Nigerin (në momentin e shkrimit të këtij dokumenti aktivitetet me Nigerin janë të pezulluara).





mundësuar shkëmbimet brenda rajoneve specifike. Për më tepër, Agjencia mund të dislokojë oficerë të ndërlidhjes, të lidhë marrëveshje pune dhe të nisë veprime mbështetëse ad hoc.

Këto mjete janë zhvilluar duke përdorur një **qasje me pjesëmarrje**, në të cilën EUAA-ja dhe autoritetet partnere bashkëpunojnë për të vlerësuar nevojat dhe për të identifikuar fushat e bashkëpunimit. Kjo qasje thekson përkushtimin e EUAA-së ndaj personalizimit të strategjive të saj të angazhimit për të përballuar me efikasitet sfidat dhe nevojat unike të çdo vendi të tretë partner, duke mundësuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe reaguese ndaj çështjeve që lidhen me azilin përtej kufijve të Bashkimit Evropian.

EUAA-ja përdor një **qasje strategjike dhe rregulluese** në menaxhimin e angazhimeve të saj të jashtme, duke zbatuar instrumentin më të përshtatshëm për planifikimin, strukturimin dhe ofrimin e mbështetjes në bazë të nevojave dhe rrethanave specifike të vendeve të treta partnere. Ky fleksibilitet strategjik është thelbësor për qasjen e EUAA-së: zgjedhja e instrumentit varet nga natyra dhe konteksti i angazhimit me një vend specifik të tretë partner.

Gjatë përmbushjes së detyrimeve të saj, EUAA-ja **bashkëpunon ngushtë me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe ndërqeveritare** përmes marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit. Këto marrëveshje, të cilat mund të marrin formën e marrëveshjeve të punës ose të kryhen përmes shkëmbimit të letrave, janë thelbësore për garantimin e koordinimit efikas dhe shmangien e përsëritjes së përpjekjeve.

Për të përmirësuar **koordinimin me institucionet e BE-së**, Agjencia zyrtarizoi një Marrëveshje Pune për Bashkëpunimin e Veprimit të Jashtëm me Drejtorinë e Përgjithshme për Migracionin dhe Çështjet e Brendshme (DG HOME) në vitin 2018 dhe një Marrëveshje Pune me Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS) në vitin 2021.

Përfshirja e shteteve të BE+

Shtetet e BE+ luajnë një rol vendimtar në hartimin dhe zbatimin e instrumenteve të bashkëpunimit të EUAA-së në dimensionin e jashtëm, në sajë të aftësisë së tyre për të ofruar **ekspertizë të përshtatur ëe nevojat dhe situatat unike** të vendeve të treta partnere. Kontributi i shteteve të BE+ shtrihet përtej ndarjes tradicionale të njohurive, duke përfshirë angazhimin aktiv në diskutime gjatë fazës së hartimit të projektit.

Shtetet e BE+ ofrojnë gjithashtu **informacione të vlefshme** që janë rezultat i përvojës së gjerë në çështjet që lidhen me azilin. Përfshirja e tyre e drejtpërdrejtë në formësimin e projekteve garanton përputhjen e nismave me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën më të mira, duke përmirësuar kështu efikasitetin dhe rëndësinë e tyre. Ekspertët e BE+ mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në dialog, duke lehtësuar dhe mundësuar një qasje bashkëpunuese që merr parasysh ngjyrimet ligjore, sociale dhe kulturore të vendeve të treta partnere.

Përfshirja e drejtpërdrejtë e BE+ përfshin angazhimin praktik në ofrimin e mbështetjes. Kjo pjesëmarrje dinamike mundëson transferimin e përvojave praktike nga kontekstet ekzistuese qeverisëse dhe të sferës politike, duke nxitur shkëmbimet mes ekspertëve dhe duke sjellë rezultate më të qëndrueshme në zhvillimin e kapaciteteve të vendeve të treta partnere.




Për më tepër, angazhimi i shteteve të BE+ në instrumentet e bashkëpunimit ofron një **platformë për rrjetëzim dhe bashkëpunim**. Ky bashkëpunim shtrihet përtej objektit të menjëhershëm të projektit, duke krijuar mundësi që profesionistët të takohen, të ndajnë përvoja dhe të shkëmbejnë praktikatat më të mira. Ky rrjetëzim nxit një komunitet praktik, duke lehtësuar mësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm në sferën e nismave që lidhen me azilin.

Objektivat e katalogut

Katalogu i veprimit të jashtëm i EUAA-së mund të **përdoret për të lehtësuar dhe mundësuar procesin e angazhimit** midis EUAA-së dhe vendeve të treta partnere, si dhe të informojë procesin e negocimit dhe hartimit të udhërrëfyesve dhe instrumenteve të tjera të bashkëpunimit. Ky katalog përfaqëson një kuadër referencash gjatë konsultimeve jozyrtare me vendet e treta partnere, duke ofruar informacione dhe njohuri thelbësore rreth objektit dhe përmbajtjes së mundshme të mbështetjes së EUAA-së.

Në këtë drejtim, katalogu mund të përfaqësojë një mjet të dobishëm nëpër faza të ndryshme, siç përcaktohet në fluksin e mëposhtëm të punës:



Si pjesë e **Fazës 0**, katalogu publikohet në faqen e internetit të EUAA-së dhe shpërndahet rregullisht mes bashkëbiseduesve të EUAA-së. Faza 0 është një hap paraprak dhe i përgjithshëm që synon të rrisë njohuritë e përgjithshme rreth mbështetjes që mund të zbatohet EUAA-ja në vendet e treta partnere.

Faza 1 i referohet përdorimit të katalogut gjatë konsultimeve jozyrtare midis EUAA-së dhe vendeve të treta partnere. Ai mund të përdoret si burim informacioni për diskutimin rreth mbështetjes së EUAA-së dhe burim identifikimi i fushave prioritare në të cilat duhen vlerësuar nevojat.

Në **Fazën 2**, katalogu mund të përdoret për identifikimin e llojeve specifike të mbështetjes, në përgjigje të nevojave të vendeve të treta partnere dhe për garantimin e ushtrimit eficient dhe efikas të përcaktimit të prioriteteve. Gjithashtu, katalogu shërben si baza për hartimin e udhërrëfyesve për bashkëpunimin.

Katalogu synon gjithashtu të **përforcojë metodologjinë e programimit** që bazohet te nevojat dhe synon të arrijë rezultatet. Katalogu synon të **rrisë ndërgjegjësimin** për gamën e gjerë të veprimeve mbështetëse që ofrohen nga EUAA-ja pranë shteteve të BE+ dhe vendeve të treta partnere.

Ky katalog përfaqëson një **kuadër jo të detyrueshëm që plotëson procesin e përbashkët të vlerësimit të nevojave** që kryhet nga **Agjencia dhe vendi i tretë partner përkatës**. Procesi i përbashkët i vlerësimit të nevojave përfshin përpjekjet e bashkëpunimit për identifikimin e fushave prioritare që kërkojnë mbështetje. Nga ana tjetër, katalogu lehtëson dhe mundëson identifikimin e fushave të mundshme të bashkëpunimit pa përcaktuar veprime specifike. Në vend të kësaj, ai mbështet një proces bashkëpunimi rreth programimit.

Vendimet mbi zgjedhjen e aktiviteteve për t'u ndjekur merren në bashkëpunim, duke marrë parasysh faktorët si **nevojat e aktorëve të përfshirë, burimet e disponueshme dhe konteksti lokal**. Kjo qasje garanton personalizimin e veprimeve mbështetëse ndaj çdo rrethane unike dhe prioriteti të vendeve të treta partnere, duke promovuar kështu rezultate të qëndrueshme dhe me ndikim. Katalogu shërben si një **udhëzues dinamik**, i cili inkurajon fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë në hartimin e veprimeve mbështetëse efikase.

Për më tepër, aktivitetet e përmendura në çdo lloj mbështetjeje janë joshteruese dhe synojnë të japin shembuj të llojeve të mundshme të mbështetjes. Gjithashtu, titulli dhe përmbajtja e moduleve të trajnimit dhe publikimeve të EUAA-së **mund të përditësohen me kalimin e kohës**. Ndaj, përdoruesit inkurajohen që t'u referohen faqeve përkatëse në faqen e internetit të EUAA-së². Së fundi, katalogu synohet të jetë një dokument dinamik, që lejon përditësime dhe modifikime për të adresuar nevojat dhe prioritetet e ndryshueshme në të ardhmen.

Struktura e katalogut

Në përputhje me modelin e udhërrëfyesit, katalogu i veprimit të jashtëm i EUAA-së është i strukturuar rreth **tre fushave kryesore të bashkëpunimit**:

Kontributi në forcimin dhe krijimin e legjislacionit, institucioneve dhe sistemeve të azilit, në përputhje me standardet e CEAS dhe të BE-së

Kontributi në procedurat efikase të azilit

Kontributi në një sistem efikas pritjeje

Çdo fushë ndahet në **nënkapituj** që përcaktojnë llojet e ndryshme të veprimeve në mënyrë të përgjithshme dhe skematike, duke përfshirë një përshkrim të përgjithshëm të mbështetjes, rezultatet dhe realizimet e synuara të saj, si dhe aktivitetet e propozuara. Sipas rastit, disa trajnime, publikime ose mjete specifike të EUAA-së jepen gjithashtu si referencë.

² <https://euaa.europa.eu/training> dhe https://euaa.europa.eu/publications?field_category_target_id=All&language=en&field_geo_coverage_target_id=&field_id_keywords_target_id=&title=

U sillen në vëmendje përdoruesve të këtij dokumenti që katalogu përfaqëson **një përpjekje për të ndarë, organizuar dhe paraqitur llojet e ndryshme të mbështetjes** që zbatohen më pas në mjedise të ndërlikuara dhe të larmishme dhe prandaj mund të ndryshojnë në objekt dhe madhësi. Si rrjedhojë, llojet e mbështetjes që përshkruhen këtu mund të kombinohen, përshtaten dhe rregullohen sipas kontekstit dhe nevojave specifike të vendit të tretë partner.



1) Kontributi në forcimin dhe krijimin e legjislacionit, institucioneve dhe sistemeve të azilit, në përputhje me standardet e CEAS dhe të BE-së


Ky seksion përqendrohet në **zhvillimin dhe zbatimin e bazave ligjore në përputhje me CEAS-in**, thelbësore për mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenies së azilkërkuesve dhe refugjatëve, ndërsa promovojnë një qasje të standardizuar në të gjitha shtetet e përfshira.

Përmes udhëzimeve teknike dhe dialogut konstruktiv, EUAA-ja mund t'i asistojë autoritetet kombëtare **në zhvillimin dhe forcimin e kuadrit të tyre për azilin** për të garantuar harmonizimin me CEAS-in. **Mbështetja për qeverisjen** përfshin këshillat rreth rishikimit të modeleve dhe strategjive kombëtare për azilin dhe pritjen, si dhe përmirësimin e mekanizmave të koordinimit mes aktorëve përkatës të përfshirë në nivel qendror.

Për më tepër, EUAA-ja mund të kontribuojë në **zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve** përgjegjëse për çështjet e azilit në vendet e treta partnere përmes trajnimeve të personalizuar, udhëzimeve teknike dhe ndarjes së informacioneve.

Brenda këtij kuadri, **shkëmbimi i praktikave më të mira** me shtetet e BE+ dallohet si element kritik. EUAA-ja promovon mësimin e përbashkët përmes lehtësimit dhe mundësimin të ndarjes së qasjeve dhe metodologjive të suksesshme, duke i lejuar vendet e treta partnere që të përfitojnë nga përvojat dhe strategjitë e shteteve të BE+ duke kontribuar më shumë në përmirësimin e sistemeve të tyre të azilit dhe pritjes.

Seksioni i radhës do të përcaktojë **fushat kryesore në të cilat EUAA-ja mund të ofrojë mbështetje** ndaj vendeve të treta partnere, duke theksuar rezultatet dhe realizimet e synuara, si dhe listën e aktiviteteve treguese që mund të zbatohen në çdo fushë të mbështetjes.





Zhvillimi dhe/ose përafrimi i legjislacionit dhe sistemeve të azilit dhe pritjes me CEAS-in.

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

EUAA-ja merr përsipër të bashkëpunojë ngushtë me vendet e treta partnere për të **mbështetur përafrimin e legjislacionit të tyre ekzistues me CEAS-in dhe për të rritur efikasitetin e sistemeve të tyre të azilit dhe pritjes.**

Në këtë kuadër, EUAA-ja vepron si përcjellës për transferimin e njohurive, duke ndarë praktikatat më të mira dhe njohuritë e fituara nga përvoja e shteteve të BE+. Jo vetëm që kjo rrit aftësitë e vendeve të treta partnere, por kontribuon gjithashtu në objektivin më të gjerë **të përcaktimit të një të kuptuari të përbashkët** të modeleve dhe strategjive **të azilit dhe pritjes** mes shteteve të BE-së dhe vendeve të treta partnere.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Rezultati i synuar i kësaj mbështetjeje është dhënia e kontributit në hartimin ose rishikimin e një kuadri ligjor që u mundëson vendeve të treta partnere të ndërtojnë sisteme të shpejta dhe efikase të azilit në bazë të standardeve të CEAS-it, ndërsa mbrohen të drejtat dhe dinjiteti i azilkërkuessve.

Aktivitetet treguese

- Ofrimi i këshillimit të specializuar mbi legjislacionin, strategjitë dhe modelet ekzistuese kombëtare të azilit ose pritjes, për të identifikuar përmirësimet e mundshme me qëllim lehtësimin dhe mundësimin e pëafrimit me CEAS-in;
- Organizimi i seminareve ad-hoc mbi tema që lidhen me zhvillimin ose rishikimin e legjislacionit, strategjive dhe modeleve kombëtare;
- Organizimi i një procesi këshillimi me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në sistemet e azilit dhe të pritjes;
- Ndarja e modeleve, praktikave të mira dhe strategjive të miratuara nga shtetet e BE+, duke përfshirë në kontekstin e rrjeteve tematike të EUAA-së;
- Organizimi i vizitave studimore në shtetet e BE+ për ndarjen e informacionit mbi modelet e azilit dhe të pritjes, praktikatat më të mira, mekanizmat operacionale dhe planifikimin strategjik;
- Mbështetja e trajnimit dhe zhvillimit profesional të personelit të azilit dhe pritjes të përfshirë në hartimin e strategjive;
- Promovimi i pjesëmarrjes në modulet përkatëse të trajnimit të EUAA-së;
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.





Koordinimi mes aktorëve përkatës të përfshirë në menaxhimin e azilit dhe të pritjes

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

Duke marrë parasysh **rëndësinë kritike të institucioneve të mirëkoordinuara dhe garancive të forta procedurale në procesin e azilit**, EUAA-ja ndërmerr një qasje gjithëpërfshirëse në bashkëpunimin me vendet e treta partnere. EUAA-ja mbështet në mënyrë aktive vendet e treta partnere në **zhvillimin e mekanizmave efikase të koordinimit** mes të gjithë aktorëve të përfshirë që luajnë një rol në sistemin e azilit dhe të pritjes, duke përfshirë, por jo vetëm, agjencitë qeveritare dhe joqeveritare, institucionet, organizatat partnere që operojnë në një mori fushash, si p.sh. shëndetësia, zbatimi i ligjit, arsimi, shërbimet sociale, mbrojtja e fëmijëve dhe integrimi.

Përmes nxitjes së bashkëpunimit dhe komunikimit efikas, EUAA-ja kontribuon në krijimin ose përmirësimin e një kuadri koheziv institucional brenda vendeve të treta partnere. Kjo qasje shtrihet deri në krijimin e rrjeteve mes ekspertëve, ku ekspertët e fushave të ndryshme bashkëpunojnë në trajtimin e aspekteve specifike të procedurave të azilit. Këto grupe pune mund të shërbejnë si platforma për shkëmbimin e njohurive, përballimin e sfidave në kohë reale dhe hartimin kolektiv të zgjidhjeve për përmirësimin e efencës dhe efikasitetit të përgjithshëm të sistemeve të azilit.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Objekti është krijimi i institucioneve që veprojnë në përputhje me standardet e përcaktuara të sundimit të ligjit lidhur me administratat publike për të siguruar reagimin e sinkronizuar dhe të mirëkoordinuar kundrejt sfidave të ndërlikuara që paraqesin azili dhe pritja. EUAA-ja ndihmon në forcimin e bazave institucionale të vendeve të treta partnere, duke kontribuar në thjeshtësimin e një procesi azili që ka në fokus të drejtat.

Aktivitetet treguese

- Mbështetja e autoriteteve në krijimin dhe hartëzimin e mekanizmave dhe platformave kombëtare të koordinimit që përfshijnë aktorët përkatës të përfshirë;
- Mbështetja në identifikimin e mangësive kryesore në koordinimin dhe komunikimin brenda sistemit;
- Këshillimi mbi ose lehtësimi dhe mundësimi i krijimit të rrjeteve mes ekspertëve, të cilat përbëhen nga pikat e kontaktit të aktorëve përkatës të përfshirë, për të adresuar sfidat, identifikuar veprimet e mundshme dhe për të ofruar përditësime;
- Ofrimi i mbështetjes teknike në zhvillimin ose rishikimin e udhëzimeve, procedurave standarde të veprimit (PSV) dhe mjeteve praktike mbi rrjedhën e komunikimit, rolet dhe përgjegjësitë;
- Përmirësimi i sinergjive, duke përfshirë flukset e punës dhe kanalet e komunikimit, me aktorët përkatës të përfshirë për të forcuar bashkëpunimin dhe efikasitetin.





Forcimi i kapacitetit të autoriteteve kombëtare në menaxhimin e ndryshimeve për të përmirësuar sistemet e azilit dhe të pritjes

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

EUAA-ja mund të ofrojë këshilla udhëzuese dhe teknike **për të mbështetur ndryshimin, rregullimin ose zhvillimin organizativ** që kërkohet për të krijuar ose përmirësuar sisteme efikase të azilit dhe pritjes, në përputhje me kuadrin ligjor, standardet dhe praktikatat më të mira të BE-së.

Në varësi të kontekstit dhe nevojave përkatëse, kjo mbështetje mund të fokusohet në sistemin e azilit, sistemin e pritjes ose të dyja ose në fushat specifike ku kërkohet ndryshim në strukturën organizative.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Kjo fushë bashkëpunimi synon të mbështesë zhvillimin ose forcimin e efikasitetit, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së kuadrove menaxhuese për azilin dhe pritjen. Për më tepër, hartimi, planifikimi dhe zbatimi i strategjisë dhe strukturës së burimeve njerëzore do të lehtësojnë dhe mundësojnë kalimin në strategjitë e identifikuarat rishtazi ose të rishikuara dhe në cilësinë e proceseve.

Aktivitetet treguese

- Mbështetja për hartimin e diagrameve organizative dhe përcaktimin e ndryshimeve strukturore dhe operacionale që nevojiten për të përmirësuar sistemet e azilit dhe/ose të pritjes.
- Mbështetja për identifikimin e mangësive në kompetenca, bazuar në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve Sektoriale (ESQF) dhe zhvillimin e një plani për zhvillimin e kapaciteteve;
- Mbështetja për identifikimin e nevojave të trajnimit të stafit të azilit dhe pritjes, si dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë;
- Mbështetja për zhvillimin e një plani kombëtar trajnimi për personelin e azilit dhe të pritjes;
- Lehtësimi dhe mundësimi dhe mbështetja e ofrimit të seancave kombëtare ose rajonale të trajnimit;
- Nxitja e pjesëmarrjes në modulet përkatëse të trajnimit të EUAA-së;
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së;

Planifikimi i emergjencave

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

Planifikimi i emergjencave është një aspekt thelbësor i **menaxhimit të situatave me fluks të lartë në mënyrë efikase dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare**, i cili mbulon veprimet që duhen ndërmarrë përpara, gjatë dhe pas këtyre ngjarjeve. Ky planifikim është i rëndësishëm, sidomos në sigurimin e menaxhimit të përshtatshëm të personave të cënueshëm.





EUAA-ja ofron **mbështetje teknike në procesin e zhvillimit ose rishikimit të planeve të emergjencave**. Këtu përfshihet ofrimi i udhëzimeve, komenteve dhe rekomandimeve të specializuara gjatë zhvillimit ose rishikimit të planeve të emergjencave në vendet e treta partnere. Përmes këtyre përpjekjeve, EUAA-ja kontribuon në **forcimin e kapaciteteve të përgjithshme të gatishmërisë dhe reagimit** të autoriteteve kombëtare për menaxhimin efikas të situatave me fluks të lartë.

EUAA-ja mbështet gjithashtu vendet e treta partnere për të garantuar që planet e emergjencave të përfshijnë mjete dhe procedura efikase për identifikimin dhe referimin e të miturve të pashoqëruar. Kjo u siguron atyre marrjen e asistencës dhe shërbimeve të nevojshme në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për më tepër, EUAA-ja lehtëson dhe mundëson përmirësimin e aftësive dhe gatishmërisë së autoriteteve kombëtare përmes seminareve dhe ndarjes së ekspertizës në planifikimin e emergjencave nga shtetet e BE+.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Kjo mbështetje synon të përmirësojë kapacitet e përgjithshme të gatishmërisë dhe reagimit nga ana e autoriteteve kombëtare për menaxhimin e flukseve të mëdha përmes ofrimit të udhëzimeve të specializuara gjatë procesit të zhvillimit dhe rishikimit të planeve të emergjencave. Ajo siguron gjithashtu që planet e emergjencave të përfshijnë mjete dhe procedura efikase për identifikimin dhe referimin e të miturve të pashoqëruar, duke garantuar marrjen e asistencës së nevojshme nga ana e tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare. Së fundi, kjo përpjekje synon të përmirësojë aftësitë dhe gatishmërinë e autoriteteve kombëtare, duke i fuqizuar ato për të zbatuar me efikasitet planet e emergjencave.

Aktivitetet treguese

- Mbështetja për zhvillimin ose rishikimin e planit të emergjencave përmes ofrimit të metodologjisë dhe udhëzimeve, komenteve dhe rekomandimeve teknike mbi modelin e planit të emergjencave dhe metodologjinë e planifikimit të emergjencave;
- Udhëzime teknike mbi strukturimin e procesit të zhvillimit dhe rishikimit të planifikimit të emergjencave (si p.sh. mbështetja në përcaktimin e institucioneve që duhen përfshirë në renditjen tematike të mbledhjeve të grupit të caktuar të punës etj.);
- Ofrimi i komenteve të specializuara në përgatitjen për zbatimin e planeve të emergjencave;
- Mbështetja për zhvillimin e skenarëve dhe të planeve përkatëse të reagimit;
- Mbështetja për hartimin dhe ekzekutimin e ushtrimeve testuese për përmirësimin e aftësive të gatishmërisë dhe reagimit;
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.

Transformimi dixhital

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

EUAA-ja thekson jashtëzakonisht rëndësinë e inovacionit dixhital. Ai përfshin përmirësimin e proceseve të azilit dhe sistemeve të pritjes përmes dixhitalizimit të procedurave shkresore ose **optimizimit të proceseve ekzistuese përmes përdorimit të mjeteve dixhitale**.



Ndonëse inovacioni dixhital dhe përparimi teknologjik kanë qenë prej kohësh prioritet për shtetet e BE+ dhe Agjencinë, **pandemia COVID-19 shërbeu si një katalizator që përshpejtoi përpjekjet e dixhitalizimit**. Dixhitalizimi i proceseve të azilit është thelbësor për të përmirësuar efikasitetin e procedurave të azilit dhe për të krijuar procese të përshkallëzuara që mund të përballojnë rritjet e papritura të numrit të aplikimeve të reja.

EUAA-ja mund të ofrojë mbështetje ndaj vendeve të treta partnere për identifikimin e mundësive për transformimin dixhital brenda sistemeve të tyre të azilit. Përmes ofrimit të ekspertizës dhe udhëzimeve, EUAA-ja i fuqizon vendet e treta partnere që të **eksplorojnë dhe zbatojnë zgjidhje dixhitale që përmirësojnë efencën dhe efikasitetin e proceseve të tyre të azilit**, duke nxitur dhe mbështetur një qasje bashkëpunimi ndaj përparimeve teknologjike në peizazhin global të azilit.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Objekti është kombinimi i menaxhimit të njohurive tradicionale me zgjidhjet moderne teknologjike, thjeshtimin e proceseve dhe garantimin e aksesueshmërisë më të mirë në informacione që lidhen me azilin. Rezultatet përfshijnë metodologjitë e dokumentuara, raportet mbi mundësitë e transformimit dixhital dhe praktikën e përmirësuar të menaxhimit të njohurive.

Aktivitetet treguese

- Vlerësimi i nevojave, rishikimi i sistemeve dhe proceseve ekzistuese dhe identifikimi i fushave për përmirësim;
- Identifikimi i praktikave dhe modeleve më të mira në shtetet e BE+ që plotësojnë nevojat e vendeve të treta partnere;
- Ofrimi i rekomandimeve mbi proceset që lidhen me hartimin.





Angazhimi ndërkombëtar

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

EUAA-ja përfshihet në mënyrë aktive në zhvillimin e kapaciteteve të vendeve të treta partnere, duke e shtrirë mbështetjen e saj përtej kontekstit kombëtar me qëllim mundësimin e **pjesëmarrjes domethënëse të tyre në projektet dhe nismat ndërkombëtare** që lidhen me azilin. Ky angazhim synon të nxisë dhe mbështesë shkëmbimin strategjik të njohurive në nivel rajonal dhe global.

EUAA-ja mund të lehtësojë dhe mundësojë lidhjen midis vendeve të treta partnere dhe rrjeteve, organizatave dhe nismave ekzistuese ndërkombëtare të dedikuara ndaj mbrojtjes ndërkombëtare. Kjo qasje bashkëpunimi lejon shkëmbimin e përvojave, mësimave të nxjerra dhe zgjidhjeve novatore në një shkallë më të gjerë, ndërsa nxit bashkëpunimin dhe partneritetet. Gjithashtu, ky angazhim **përmirëson vizibilitetin** e vendeve të treta partnere në skenën ndërkombëtare.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Synimi është promovimi i pjesëmarrjes aktive dhe angazhimi i vendeve të treta partnere në projektet dhe forumet ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen ndërkombëtare, duke përmirësuar shkëmbimin e praktikave më të mira dhe bashkëpunimin. Rezultatet përfshijnë nismat e dokumentuara të bashkëpunimit, raportet e pjesëmarrjes dhe kapacitetet e përmirësuara për angazhimin efikas ndërkombëtar në projektet që lidhen me azilin.

Aktivitetet treguese

- Mbështetja e pjesëmarrjes në aktivitetet tematike të EUAA-së ose shtetit të BE+;
- Mbështetja e pjesëmarrjes në seminarët rajonale mbi temat që lidhen me zhvillimin dhe përforcimin e sistemeve të azilit dhe pritjes;
- Mbështetja e pjesëmarrjes së koordinuar në forume globale për diskutime rreth azilit dhe migrimit.



2) Kontributi në procedurat efikase të azilit

Ky seksion trajton aspektet themelore që kontribuojnë në **efikasitetin e procedurave të azilit** në fuqi në secilin vend të tretë partner.

EUAA-ja i mbështet autoritetet kombëtare në përmirësimin e menaxhimit të procedurave të tyre të azilit përmes **hartimit dhe rishikimit të flukseve të punës, dokumenteve udhëzuese, PSV-ve dhe mjeteve**, për të përmirësuar sistematizimin, harmonizimin dhe llogaridhënien e sistemit ndërkombëtar të mbrojtjes.

Për më tepër, ky seksion fokusohet në forcimin e kapacitetit të zyrtarëve të kontaktit të parë për të siguruar **akses efikas në procedurat e azilit, identifikim dhe referim** të menjëhershëm të **personave me cenueshmëri** dhe/ose nevoja të veçanta, si dhe **ofrimin e informacionit përkatës** mbi të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve. Ai përfshin gjithashtu **përpunimin cilësor të kërkesave për azil në shkallën e parë dhe të dytë** për të përmirësuar transparencën, koherencën dhe llogaridhënien. Së fundi, janë bërë përpjekje për **përmirësimin e kuptimit të procedurave të risistemimit**.



Aksesi në mbrojtjen ndërkombëtare

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

për identifikimin, regjistrimin dhe referimin e menjëhershëm të personave që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare, duke garantuar kështu akses efikas në procedurën e azilit, në përputhje me të drejtat kryesore themelore dhe detyrimet ndërkombëtare. Për më tepër, EUAA-ja mund të lehtësojë dhe mundësojë zhvillimin e materialeve të qarta informuese për aktorët kombëtarë të përfshirë dhe për kërkuesit.

Përmes **bashkëpunimit me aktorët e përfshirë**, EUAA-ja luan një rol thelbësor në zhvillimin dhe përmirësimin e kapacitetit të autoriteteve kompetente për të identifikuar, informuar dhe regjistruar menjëherë **personat që aplikojnë** për mbrojtje ndërkombëtare dhe për t'i referuar ata në rrugën përkatëse procedurale.

Kjo **qasje gjithëpërfshirëse**, e cila mbulon vlerësimin e nevojave dhe krijimin e zgjidhjeve sipas kontekstit, kontribuon në krijimin e një sistemi i cili jo vetëm garanton aksesueshmërinë, por edhe përgjigjet në mënyrë efikase ndaj nevojave unike dhe kontekstit të vendeve të treta partnere.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Kjo fushë bashkëpunimi synon të përmirësojë nëpunësit e kontaktit të parë të vendit të tretë në fitimin ose përmirësimin e aftësive të tyre të dallimit të individëve me cenueshmëri dhe atyre që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe të ofrojnë garancitë përkatëse procedurale dhe mbështetje në përputhje me CEAS-in.

Aktivitetet treguese

- Realizimi i seminareve të personalizuara mbi aksesin në procedurën e azilit dhe Udhëzuesit Praktikë dhe mjetet e EUAA-së, si p.sh. Seti i Instrumenteve për Cenueshmërinë (SNVA dhe IPSN);
- Mbështetja në zhvillimin dhe rishikimin e PSV-ve kombëtare, udhëzimeve të punës, udhëzimeve dhe mjeteve që përshkruajnë qartë detyrat, rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë, flukseve të punës dhe mekanizmave referues thelbësorë për garantimin e aksesit efikas në procedurën e azilit. Këtu mund të përfshihet integrimi i kriterëve dhe listave të kontrollit mbi identifikimin paraprak të cenueshmërisë, IPSN-ja, regjistrimi i qëllimit, regjistrimi dhe paraqitja e aplikimit);
- Mbështetja e zhvillimit, përmirësimit dhe shpërndarjes së materialeve informuese, duke përfshirë materialet e përshtatura sipas nevojave specifike të personave të cenueshëm;
- Promovimi i pjesëmarrjes në modulet përkatëse të trajnimit të EUAA-së (si p.sh., Aksesi në procedurën e azilit, regjistrimi, identifikimi i personave me nevoja të veçanta, komunikimi me azilkërkuesit);
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.



Identifikimi, vlerësimi dhe referimi i personave me cenueshmëri dhe/ose nevoja të veçanta

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

Identifikimi dhe vlerësimi në kohë i personave me cenueshmëri dhe/ose nevoja të veçanta është kritik për ofrimin e garancive procedurale/masave mbrojtëse përkatëse dhe të mbështetjes së personalizuar.

EUAA-ja mund të lehtësojë dhe mundësojë **përpyjekjet e vendeve të treta partnere për identifikimin, vlerësimin dhe referimin e personave me cenueshmëri dhe/ose nevoja të veçanta në një mënyrë të shpejtë dhe të përshtatshme në procedurën përkatëse dhe në ofruesin e shërbimit të specializuar**, duke garantuar respektimin e parimit të mosdëmtimit dhe konfidencialitetit. Kjo mbështetje mbështetet në një sërë mjetesh dhe trajnimesh të zhvilluara nga EUAA-ja, si dhe nga ekspertiza dhe praktikat më të mira të shteteve të BE+.

EUAA-ja mund t'i asistojë gjithashtu vendet e treta partnere në zhvillimin dhe zbatimin e mjeteve dhe udhëzimeve të qarta për të përmirësuar efikasitetin e proceseve.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Mbështetja synon të krijojë një proces më reagues dhe më të saktë për identifikimin dhe vlerësimin e cenueshmërisë, i cili rezulton në aksesin e menjëhershëm në mbështetje dhe në masat mbrojtëse procedurale. Realizimet përfshijnë protokolle gjithëpërfshirëse, udhëzime dhe mjete praktike që fuqizojnë vendet e treta partnere për të adresuar me mjeshtëri nevojat unike të personave të cenueshëm që nga fillimi i procedurës së azilit.

Aktivitetet treguese

- Ofrimi i këshillave teknike mbi zhvillimin e mjeteve dhe procedurave që lidhen me identifikimin, vlerësimin dhe referimin e shpejtë të personave me cenueshmëri dhe/ose nevoja të veçanta;
- Ofrimi i mbështetjes për hartimin, zbatimin ose optimizimin e mjeteve, proceseve dhe flukseve përkatëse të punës;
- Mbështetja në krijimin ose përmirësimin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave;
- Zhvillimi i seminareve dhe seancave të mentorimit mbi përdorimin e IPSN-së dhe mjeteve të referimit;
- Ofrimi i mentorimit gjatë punës mbi procedurat kombëtare të referimit për identifikimin dhe vlerësimin e cenueshmërive;
- Lehtësimi dhe mundësimi i misionëve të specializuara për prezantimin e praktikave më të mira të shteteve të BE+ mbi identifikimin, vlerësimin dhe referimin e personave me cenueshmëri dhe/ose nevoja të veçanta;
- Promovimi i pjesëmarrjes në modulet përkatëse të trajnimit të EUAA-së (si p.sh., Prezantimi i cenueshmërive, trafikimi i qenieve njerëzore, aplikantët me SOGIESC të ndryshëm, fëmijët në procesin e azilit, viktimat e dhunës me bazë gjinore);
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.



Procedurat e specializuara për të miturit e pashoqëruar dhe fëmijët e ndarë

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

Brenda kuadrit për mbështetjen ndaj personave të cënueshëm, EUAA-ja ka një fokus të veçantë mbi të miturit e pashoqëruar dhe fëmijët e ndarë dhe mund të ofrojë mbështetje të specializuar për autoritetet kombëtare të vendeve të treta partnere për sa i përket zbatimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe përmirësimit të garancive brenda procedurave të azilit për fëmijët. Më specifikisht, EUAA-ja mund të asistojë me hartimin, **rishikimin dhe optimizimin e procedurave, proceseve dhe flukseve përkatëse të punës**. Ajo gjithashtu mund të lehtësojë dhe mundësojë ofrimin e mbështetjes së specializuar, seminareve dhe seancave trajnuese në vendin e punës. Nëpërmjet shfrytëzimit të njohurive dhe përvojës së ekspertëve të EUAA-së dhe shteteve të BE+, EUAA-ja mund të ndihmojë në forcimin e aftësive të autoriteteve kompetente dhe personelit të përfshirë në interesin më të lartë të fëmijës dhe në proceset e vlerësimit të moshës. Kjo mbështetje mund të përfshijë **vlerësimin gjithëpërfshirës të kuadrove dhe praktikave aktuale ligjore** lidhur me procedurat e vlerësimit të moshës, duke shqyrtuar harmonizimin e tyre me të drejtat e fëmijëve dhe me standardet ndërkombëtare. EUAA-ja e lehtëson dhe mundëson këtë proces duke ofruar ekspertizë në analizimin e praktikave ekzistuese dhe në identifikimin e mangësive ose pengesave të mundshme në procesin e vlerësimit të moshës që respekton të drejtat.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Kjo ndërhyrje synon të mbështesë krijimin ose përmirësimin e proceseve të specializuara për të miturit e pashoqëruar, edhe brenda sistemit të pritjes, si dhe të përmirësojë koordinimin mes autoriteteve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë që janë përgjegjës për kujdesin e fëmijëve të pashoqëruar.

Aktivitetet treguese

- Vlerësimi i kuadrit ekzistues për menaxhimin e të miturve të pashoqëruar në sistemet e azilit dhe të pritjes për të identifikuar nevojat dhe mangësitë;
- Ofrimi i udhëzimeve mbi procedurat kombëtare për vlerësimin e moshës;
- Ofrimi i udhëzimeve mbi hartimin, rishikimin dhe zbatimin e protokolleve, flukseve të punës dhe PSV-ve, duke përfshirë dhënien e garancive procedurale, referimin dhe alokimin në qendrat e pritjes, skemat e kujdestarisë, VIM-in, PIM-in dhe vlerësimin e moshës;
- Zhvillimi i seminareve dhe i mentorimit në vendin e punës mbi menaxhimin e rasteve lidhur me fëmijët e pashoqëruar, rolet dhe përgjegjësitë e kujdestarëve, vlerësimin e moshës dhe VIM-in;
- Kryerja e konsultimeve me aktorët e përfshirë dhe ofrimi i udhëzimeve mbi krijimin dhe termat e referencës të grupeve të punës dhe mekanizmave të koordinimit;
- Lehtësimi dhe mundësimi i misionëve të specializuara për prezantimin e praktikave më të mira të shteteve të BE+ në vlerësimin e moshës;
- Përkthimi dhe shpërndarja e videove dhe udhëzuesit praktik të EUAA-së mbi vlerësimin e moshës;
- Promovimi i pjesëmarrjes në modulet përkatëse të trajnimit të EUAA-së;
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.



Cilësia e procesit të azilit dhe e vendimeve

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

EUAA-ja mund të mbështesë vendet e treta partnere në hartimin dhe/ose optimizimin e flukseve të punës për menaxhimin e azilit dhe sigurimin e cilësisë së depozitimit, menaxhimit të të dhënave, sistemit të planifikimit, përgatitjes së dosjeve, vendimmarrjes (duke përfshirë intervistat dhe vlerësimin e provave e të rrezikut), njoftimit të vendimeve dhe shqyrtimit të cilësisë.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Mbështetja e EUAA-së synon të përmirësojë kapacitetet e vendeve të treta partnere në përpunimin e kërkesave për azil në përputhje me standardet ndërkombëtare. Këtu përfshihet optimizimi i flukseve të punës, standardizimi i procedurave, zbatimi i PSV-ve të forta nga ana teknike dhe përmirësimi i aftësive të avancuara të personelit përkatës.

Aktivitetet treguese

- Hartëzimi dhe rishikimi i kuadrit për azilin, duke përfshirë depozitimin, intervistat, vendimmarrjen dhe aksesin në mjetet ligjore efektive;
- Vlerësimi i nevojave në flukset e punës dhe në përpunimin e aplikimeve;
- Ndihma në hartimin dhe zbatimin e PSV-ve dhe protokolleve përkatëse;
- Ofrimi i seminareve, mentorimit në vendin e punës dhe seancave këshilluese ad-hoc mbi praktikatat më të mira për të operacionalizuar dhe përmirësuar proceset, flukset e punës dhe mjetet që përdoren në menaxhimin e dosjeve të azilit;
- Ofrimi i mentorimit dhe trajnimeve në vendin e punës mbi proceset dhe teknikat e vendimmarrjes për azilin;
- Mbështetja në krijimin ose përmirësimin e njësive dhe/ose mekanizmave të sigurimit të cilësisë për të garantuar përputhshmërinë me standardet e cilësisë në azil;
- Mbështetja në zhvillimin ose përmirësimin e sistemeve të informacionit ose të të dhënave dhe të mjeteve përkatëse;
- Mbështetja e kapaciteteve të autoriteteve kombëtare mbi menaxhimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave;
- Trajnimi i stafit përkatës mbi modulet e trajnimit të EUAA-së për IVO-n;
- Organizimi i seancave të trajnimit mbi metodologjinë e IVO-s dhe/ose seancave informuese sipas vendit;
Organizimi i aktiviteteve të trajnimit dhe zhvillimit profesional për sa i përket përpunimit të apeleve në shkallën e dytë;
- Lehtësimi dhe mundësimi i misionëve të specializuara për prezantimin e praktikave më të mira të shteteve të BE+;
- Promovimi i pjesëmarrjes në modulet përkatëse të trajnimit të EUAA-së;
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.



Zhvillimi i kapaciteteve për zyrtarët e kontaktit të parë

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

Zyrtarët e kontaktit të parë luajnë një rol thelbësor pasi ata janë pika e parë e kontaktit për shtetasit e vendeve të treta dhe ngarkohen me ose mund të luajnë një rol në mundësimin dhe lehtësimin e aksesit efikas në mbrojtjen ndërkombëtare.

EUAA-ja mund t'i mbështesë vendet e treta partnere në **garantimin e mirëpërgatitjes së zyrtarëve të kontaktit të parë për të përmbushur detyrimet e tyre**, si dhe për të garantuar aksesin në procedurat e azilit dhe masat mbrojtëse procedurale për kërkuesit.

EUAA-ja mund të mbështesë gjithashtu ofrimin e seancave kombëtare të trajnimit për reaguesit e vijës së parë nga organizatat përkatëse kombëtare që asistojnë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, të miturit dhe kategoritë e tjera të personave të cënueshëm. Kjo mbështetje gjithëpërfshirëse synon të përmirësojë kapacitetin dhe njohuritë e përgjithshme të zyrtarëve të kontaktit të parë, duke promovuar kështu efencën e sistemit të azilit.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Kjo mbështetje synon të përmirësojë kapacitetin e zyrtarëve të kontaktit të parë të vendeve të treta partnere, për të siguruar që ata të kenë njohuritë dhe aftësitë e duhura për t'i informuar dhe asistuar azilkërkuesit në fazën e parë të procedurës së azilit. Përmes trajnimit të targetuar, zyrtarët mund të përmirësojnë aftësitë e tyre në identifikimin dhe adresimin e nevojave specifike, si p.sh. nevojat e viktimave të trafikimit dhe/ose të të miturve të pashoqëruar. Mbështetja përfshin gjithashtu ndarjen e praktikave më të mira dhe zhvillimin e PSV-ve për menaxhimin e qëndrueshëm të çështjeve të azilit.

Aktivitetet treguese

- Zhvillimi i trajnimeve, seminareve dhe mentorimit në vendin e punës mbi aksesin në procedurën e azilit, regjistrimin, teknikat e komunikimit dhe dhënien e informacionit, si dhe mbi identifikimin dhe referimin e cënueshmërisë;
- Lehtësimi dhe mundësimi i misionëve të specializuara për prezantimin e praktikave më të mira të shteteve të BE+ për regjistrimin;
- Zhvillimi i seminareve dhe seancave të mentorimit mbi paketën e Aksesit në Procedurën e Azilit;
- Shpërndarja e materialeve informuese mbi aksesin te procedura për zyrtarët e kontaktit të parë;
- Promovimi i pjesëmarrjes në modulet përkatëse të trajnimit të EUAA-së;
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.



Zhvillimi i kapaciteteve për nëpunësit e azilit

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

Nëpunësit e azilit luajnë një rol vendimtar në procedurën e azilit, pasi ata janë përgjegjës për regjistrimin e kërkesave për azil, zhvillimin e intervistave personale, shqyrtimin e kërkesave dhe dhënien e vendimeve. EUAA-ja mund të ofrojë mbështetje ndaj vendeve të treta partnere për **të përmirësuar zotësinë dhe aftësitë teknike të nëpunësve të azilit gjatë kryerjes së intervistave personale, në një mënyrë që është sensitive ndaj mbrojtjes dhe me një shqyrtim të plotë**, duke garantuar vendime të informuara që përputhen me CEAS-in dhe me standardet e mbrojtjes ndërkombëtare. **Mbështetja e EUAA-së ndaj nëpunësve të azilit mbulon një gamë gjithëpërfshirëse aktivitesh**, duke përfshirë programet dhe seminarat e personalizuara të trajnimit që fokusohen tek teknikat e intervistës, metodologjia e IVO-s, vlerësimi i rrezikut dhe provave, klauzolat e përfshirjes dhe përjashtimit, kriteret përcaktuese, hartimi i vendimeve dhe përfundimi i mbrojtjes. Gjithashtu, **EUAA-ja mund të lehtësojë dhe mundësojë ndarjen e njohurive midis vendeve të treta partnere dhe shteteve të BE+**, duke u mundësuar nëpunësve të azilit fitimin e përvojës së drejtpërdrejtë dhe të njohurive me procedurat dhe metodologjitë operacionale që zbatohen nga kolegët e tyre. Këto shkëmbime mund të nxisin dhe mbështesin gjithashtu bashkëpunimin dhe ndarjen e praktikave më të mira, duke përmirësuar më tutje cilësinë e vlerësimit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Përmes këtyre përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve, EUAA-ja synon t'i pajisë nëpunësit e azilit me ekspertizën dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën më të mira. Realizimet përkatëse përfshijnë module gjithëpërfshirëse trajnimi, seminare të personalizuara, si dhe mjete praktike që bashkërisht mbështesin përmirësimin e aftësive dhe njohurive teknike.

Aktivitetet treguese

- Promovimi i pjesëmarrjes në modulet përkatëse të trajnimit të EUAA-së;
- Ndarja e informacionit dhe ekspertizës nga EUAA-ja dhe shtetet e BE+ mbi vlerësimin e provave dhe të rrezikut;
- Mentorimi në vendin e punës rreth aftësive teknike (intervistat, vlerësimi i provave dhe rrezikut, shkrimi i vendimeve, vlerësimi i vendimeve dhe përdorimi i IVO-s) përmes udhëzimeve dhe mjeteve praktike të EUAA-së;
- Zhvillimi i seminareve rreth udhëzuesve praktikë përkatës, si p.sh. Udhëzuesi praktik mbi përdorimin e IVO-s nga nëpunësit e ngarkuar me trajtimin e rasteve, Udhëzuesi praktik mbi vlerësimin e provave dhe rrezikut;
- Zhvillimi i seminareve mbi metodologjinë e IVO-s dhe/ose seancave informuese sipas vendit;
- Zhvillimi i seminareve mbi identifikimin e vendit të origjinës përmes verifikimit të dokumenteve, kërkimit në mediat sociale dhe intervistës personale;
- Lehtësimi dhe mundësimi i misionëve të specializuara për prezantimin e praktikave më të mira të shteteve të BE+;
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.



Përmirësimi i të kuptuarit të procedurave të risistemimit

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

EUAA-ja është mandatuar për t'i mbështetur shtetet e BE+ në përpjekjet e tyre lidhur me risistemimin, që përfshijnë transferimin e refugjatëve të cënueshëm nga vendet pritëse në shtetet e BE+. Risistemimi u jep këtyre individëve të drejta të barabarta me përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, EUAA-ja gjithashtu mund t'i **mbështesë vendet e treta partnere në përmirësimin të kuptuarit të procedurave të risistemimit të shteteve të BE+**. Vendet e treta partnere mund të fitojnë njohuri mbi praktikën e shteteve të BE+ për sa i përket mekanizmave referues të risistemimit dhe kriterëve të pranimit. Për më tepër, EUAA-ja mund t'i asistojë vendet e treta partnere në mënyrë që këto të fundit t'i kuptojnë më mirë politikat dhe praktikën e shteteve të BE+ lidhur me pritjen, të drejtat dhe përfitimet, si dhe me integrimin e refugjatëve të risistemuar.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Mbështetja synon të përmirësojë të kuptuarit nga vendet e treta partnere të kriterëve të përzgjedhjes të shteteve të BE+ për risistemimin, si dhe rritjen e njohurive mbi praktikën efikase të integritit për të mbështetur përfshirjen e suksesshme të refugjatëve të risistemuar brenda shoqërive të tyre.

Aktivitetet treguese

- Organizimi i vizitave studimore në Qendrën për Mbështetjen me Risistemimin (RSF) të EUAA-së në Stamboll;
- Lehtësimi dhe mundësimi i ofrit të informacionit dhe ekspertizës nga EUAA-ja dhe nga shtetet e BE+ mbi risistemimin;
- Organizimi i një seminari për të kuptuar kriteret e shteteve të BE+ për pranueshmërinë për risistemimin;
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.





3) Kontributi në një sistem efikas pritjeje

Ky seksion adreson disa aspekte thelbësore për **garantimin e kushteve të përshtatshme të pritjes, përmirësimin e kapaciteteve të përpunimit dhe krijimin e flukseve efikase të punës** sipas kërkesave të CEAS-it për cilësinë.

Për më tepër, janë vlerësuar **strategjitë dhe flukset e punës për menaxhimin e rasteve në qendrat e pritjes** dhe janë identifikuar fushat për përmirësimin ose optimizimin e mëtejshëm të proceseve.

Agjencia mbështet zhvillimin e **kapaciteteve të nëpunësve të pritjes** për të rritur aftësitë dhe njohuritë e tyre, duke siguruar që ata të mund t'i përmbushin me efikasitet rolet e tyre brenda sistemit të pritjes.





Harmonizimi i kushteve të pritjes me CEAS-in

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

EUAA-ja mund t'i mbështesë vendet e treta partnere me plotësimin e detyrimeve ndërkombëtare dhe të kriterëve standarde të CEAS-it lidhur me strehimin dhe me kushtet materiale. Kjo mbështetje gjithëpërfshirëse përfshin dhënien e këshillave të specializuara mbi pritjen, duke kontribuar në harmonizimin me CEAS-in.

EUAA-ja mund të ofrojë **mbështetje me planifikimin dhe projektimin e qendrave të pritjes**, duke përfshirë rinovimin dhe përmirësimin e ambienteve ekzistuese për të garantuar që qendrat e pritjes plotësojnë kriteret dhe standardet e përcaktuara në CEAS dhe në udhëzimet e EUAA-së. Mbështetja në projektimin e qendrave mund të kombinohet me **zhvillimin dhe përmirësimin e flukseve të punës dhe proceseve** që nevojiten për të garantuar funksionimin efikas të ambienteve. Për më tepër, EUAA-ja mund të mbështesë optimizimin e menaxhimit të pritjes përmes hartimit dhe përmirësimit të proceseve, PSV-ve, flukseve të punës dhe mjeteve operacionale në nivel strukturor dhe operacional.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Kjo mbështetje synon të përmirësojë krijimin dhe funksionimin e qendrave të pritjes dhe kushteve materiale në përputhje me standardet e CEAS-it.

Aktivitetet treguese

- Hartëzimi dhe vlerësimi i modelit dhe strategjisë ekzistuese kombëtare të pritjes, si dhe identifikimi i përmirësimeve të mundshme;
- Mbështetja në hartimin ose rishikimin e procedurave, flukseve të punës, proceseve dhe praktikave lidhur me sistemin kombëtar të pritjes;
- Ofrimi i mbështetjes teknike në hartimin ose rishikimin e dokumenteve strategjike dhe udhëzuese, duke përfshirë PSV-të, dokumentet dhe protokollet e punës;
- Përmirësimi i kapacitetit të stafit të pritjes në përdorimin dhe zbatimin e PSV-ve dhe mjeteve;
- Rritja e kapacitetit të stafit të pritjes për të ofruar informacion cilësor ndaj rezidentëve;
- Rritja e kapacitetit të stafit të pritjes për të menaxhuar dhe analizuar të dhënat;
- Ofrimi ose lehtësimi dhe mundësimi i ofrit të mentorimit në vendin e punës për të mbështetur zbatimin e udhëzimeve praktike mbi kushtet e pritjes për të miturit e pashoqëruar;
- Trajnimi i stafit të pritjes rreth përdorimit të mjetit të EUAA-së për Vlerësimin e kushteve të pritjes (ARC) dhe mbështetje për përshtatjen e tij me kontekstin vendas;
- Organizimi i vizitave studimore në shtetet e BE+ për ndarjen e informacionit mbi modelet e pritjes, praktikat më të mira, mekanizmat operacionale dhe mbi planifikimin strategjik;
- Ofrimi i asistencës në procesin konsultues me aktorët e përfshirë në procesin e pritjes;
- Dhënia e aksesit dhe ofrimi i moduleve dhe mjeteve të trajnimit të EUAA-së;
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.





Përmirësimi i menaxhimit të qendrave të pritjes

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

EUAA-ja mund t'i mbështesë vendet e treta partnere me përmirësimin e menaxhimit të qendrave të pritjes. Kjo mbështetje përfshin **optimizimin e menaxhimit të pritjes dhe përmirësimin e proceseve**, flukseve të punës, mjeteve operacionale dhe Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për të përmirësuar efikasitetin dhe harmonizuar procedurat që lidhen me pritjen.

EUAA-ja mund të ofrojë mbështetje në vlerësimin e flukseve aktuale të punës brenda qendrave të pritjes, të ofrojë **rekomentime që synojnë thjeshtësimin e proceseve dhe përmirësimin e efikasitetit operacionale**. EUAA-ja mund të mbështesë zhvillimin e mjeteve dhe PSV-ve të personalizuar për të adresuar sfidat specifike që janë identifikuar gjatë procesit të vlerësimit, duke ofruar udhëzime të qarta për detyrat dhe përgjegjësitë e stafit. EUAA-ja mund të lehtësojë dhe mundësojë gjithashtu **ndarjen e ekspertizës teknike dhe praktikave të mira të shteteve të BE+ dhe të stafit të brendshëm**, për të garantuar një qasje të personalizuar që harmonizohet me kontekstin operacional dhe procedural të vendeve të treta partnere.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Kjo mbështetje synon të identifikojë së bashku me vendet e treta partnere fushat e mundshme për përmirësim lidhur me menaxhimin e qendrave të pritjes, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të mjeteve dhe flukseve të përshtatshme të punës që personalizohen për të rritur efikasitetin dhe ekspertizën në këtë kuadër.

Aktivitetet treguese

- Vlerësimi i nevojave dhe identifikimi i fushave në të cilat harmonizimi, zhvillimi dhe përmirësimi i proceseve, hartimi i dokumenteve strategjike dhe udhëzuese kanë rëndësi;
- Identifikimi i fushave për përmirësim në sistemin ekzistues të ofrimit të informacionit dhe në përbajtje përmes vlerësimit të nevojave për komunikim dhe informacion;
- Ofrimi i udhëzimeve mbi menaxhimin e informacionit dhe të dhënave në sistemin e pritjes;
- Identifikimi i praktikave të mira dhe modeleve më të mira në shtetet e BE+, të cilat mund të zbatohen sipas nevojave specifike ose kontekstit të vendit të tretë partner;
- Ofrimi i mbështetjes së specializuar dhe këshillave operacionale mbi menaxhimin e qendrave të pritjes;
- Mbështetja në zhvillimin dhe zbatimin e PSV-ve dhe mjeteve që mund të zbatohen në kontekstin e qendrave të pritjes;
- Dhënia e orientimeve për zhvillimin e udhëzimeve, PSV-ve dhe mjeteve praktike në nivel kombëtar dhe vendor, për koordinimin mes aktorëve të ndryshëm të përfshirë në ofrimin e shërbimit, për kanalet dhe rrugët e komunikimit, për rolet dhe përgjegjësitë/termat e referencave;
- Mbështetja në krijimin dhe zbatimin e mekanizmave të koordinimit mes grupeve të interesit dhe ofruesve të shërbimit brenda qendrave të pritjes;
- Lehtësimi dhe mundësimi i pjesëmarrjes së stafit të pritjes në modulet e trajnimit të EUAA-së që lidhen me pritjen;
- Zhvillimi i seminareve rreth udhëzimeve dhe mjeteve përkatëse të EUAA-së lidhur me pritjen;
- Dhënia e kontributit në hartimin e materialeve audio-vizive, materialeve të printuara dhe mjeteve dixhitale të informacionit përmes prezantimit të metodologjisë "Rreth azilit" dhe bibliotekës on-line;





- Organizimi i vizitave studimore në shtetet e BE+ për ndarjen e informacionit rreth pritjes;
- Përkthimi dhe pilotimi i mjetit të EUAA-së për Vlerësimin e kushteve të pritjes (ARC);
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.





Identifikimi, vlerësimi dhe referimi i cenueshmërive dhe menaxhimi efikas i rasteve në pritje

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

EUAA-ja i mbështet vendet e treta partnere në përmirësimin e **identifikimit, vlerësimit dhe referimit efikas të personave të cenueshëm dhe personave me nevoja të veçanta** brenda sistemeve të tyre të pritjes (duke përfshirë të miturit e pashoqëruar dhe fëmijët e ndarë). Nëpërmjet asistencës së personalizuar dhe nismave të bashkëpunimit, EUAA-ja kërkon të forcojë kapacitetin e autoriteteve kombëtare dhe institucioneve përkatëse në ofrimin e shërbimeve dhe masave mbrojtëse të veçanta ndaj kërkuesve me cenueshmëri dhe/ose nevoja të veçanta.

EUAA-ja mund t'i **mbështesë autoritetet kombëtare në hartimin dhe zbatimin e kuadrove të standardizuara për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar rastet me cenueshmëri në të gjithë sistemin kombëtar të pritjes**. Për më tepër, EUAA-ja mund të ofrojë këshilla mbi përmirësimin e mekanizmave dhe proceseve të koordinimit për të optimizuar ndërveprimin midis institucioneve të specializuara dhe sistemeve të azilit dhe pritjes, sidomos për të miturit e pashoqëruar.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Mbështetja e EUAA-së fokusohet në fuqizimin e vendeve të treta partnere për të zhvilluar ose forcuar sisteme pritjeje gjithëpërfshirëse dhe përfshirëse që adresojnë me efikasitet nevojat e personave të cenueshëm, duke përfshirë të miturit e pashoqëruar. Përmes shfrytëzimit të ekspertizës, nxitjes së bashkëpunimit dhe zbatimit të mbështetjes së personalizuar, EUAA-ja kontribuon në ofrimin e shërbimeve dinjitoze dhe mbështetëse të pritjes, të masave mbrojtëse procedurale dhe ofrimin e specializuar të shërbimit për kërkuesit me nevoja të veçanta, veçanërisht për të miturit e pashoqëruar.

Aktivitetet treguese

- Identifikimi, hartëzimi dhe vlerësimi i nevojave që lidhen me menaxhimin e personave të cenueshëm;
- Ndërmarrja e konsultimeve me autoritetet e azilit dhe të pritjes, si dhe me aktorët e përfshirë mbi mekanizmat e koordinimit;
- Ofrimi i udhëzimeve dhe mbështetja ndaj hartimit dhe përmirësimit të protokolleve të dedikuara, flukseve të punës, PSV-ve, mekanizmave të referimit dhe alokimit në qendrat e pritjes dhe për grupet përkatëse të interesit;
- Ofrimi ose lehtësimi dhe mundësimi i ofrimit të mentorimit në vendin e punës për sa i përket identifikimit dhe menaxhimit të rasteve të grupeve të cenueshme;
- Vlerësimi i kuadrit ekzistues për menaxhimin e të miturve të pashoqëruar në sistemet e pritjes për të identifikuar nevojat dhe mangësitë;
- Ofrimi i udhëzimeve mbi procedurat kombëtare për vlerësimin e moshës;
- Ofrimi i udhëzimeve mbi hartimin, rishikimin dhe zbatimin e protokolleve, flukseve të punës dhe PSV-ve, duke përfshirë dhënien e garancive procedurale, referimin dhe alokimin në qendrat e pritjes, skemat e kujdestarisë, VIM-in, PIM-in dhe vlerësimin e moshës;
- Lehtësimi dhe mundësimi i pjesëmarrjes në trajnime dhe në mentorim në vendin e punës, brenda kontekstit të pritjes së UAM-ve, duke përfshirë ILF-në dhe rolet e përgjegjësitë e kujdestarëve;



- Angazhimi i stafit përkatës në trajnime, seminare dhe/ose në mentorim në vendin e punës lidhur me zbatimin e garancive të veçanta, protokolleve, PSV-ve dhe mjeteve për cënueshmërinë dhe UAM-të (duke përfshirë, por jo vetëm, IPSN-në, SNVA-në, Paketën e Instrumenteve të Referimit, Mjetet Praktike të EUAA-së për kujdestarët, menaxhimin e rasteve në pritje);
- Lehtësimi dhe mundësimi i pjesëmarrjes në seminare dhe shkëmbime tematike mbi menaxhimin e rasteve në pritje;
- Zhvillimi i një seminari mbi Udhëzimet e EUAA-së për kushtet e pritjes;
- Organizimi i vizitave studimore në shtetet e BE+ për ndarjen e informacionit rreth identifikimit, referimit dhe menaxhimit të personave të cënueshëm, duke përfshirë të miturit e pashoqëruar;
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.





Zhvillimi i kapaciteteve të nëpunësve të pritjes

Përshkrim i përgjithshëm i mbështetjes

Kjo mbështetje mbulon nisma të ndryshme që synojnë të përmirësojnë aftësitë, njohuritë dhe kompetencat e nëpunësve të përfshirë në menaxhimin e qendrave dhe shërbimeve të pritjes. Kjo mbështetje përfshin ofrimin e **programeve të specializuara të trajnimit që janë përshtatur ndaj nevojave të nëpunësve të pritjes**, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash, duke përfshirë procedurat e pritjes, standardet ndërkombëtare (UNHCR dhe IOM), praktikat më të mira në menaxhimin e qendrave të pritjes, si dhe punën me personat e cënueshëm. Kjo mbështetje synon gjithashtu të përmirësojë aftësitë sociale të nëpunësve, të cilat janë të rëndësishme në kontekstin e pritjes, si p.sh. vendosja e kufijve profesionalë, komunikimi në një mjedis ndërkulturor, menaxhimi i grupeve të interesit dhe konflikteve. Përmes këtyre programeve të trajnimit, nëpunësit e pritjes fitojnë ekspertizën dhe aftësitë e nevojshme për të trajtuar sfida të ndryshme dhe për të garantuar veprimtarinë pa probleme të qendrave të pritjes.

Për më tepër, EUAA-ja **lehtëson dhe mundëson ndarjen e njohurive dhe mundësi për shkëmbime për nëpunësit e pritjes** përmes seminareve praktike, seminareve dhe vizitave studimore në shtetet e BE+ dhe në Qendrën Operacionale të EUAA-së. Këto platforma u mundësojnë nëpunësve që të mësojnë nga përvojat e njëri-tjetrit, të shkëmbejnë praktikat më të mira dhe të qëndrojnë të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në fushën e pritjes së azilkërkuesve. Përmes nxitjes dhe mbështetjes së bashkëpunimit dhe rrjetëzimit mes nëpunësve të pritjes, EUAA-ja kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të ofruara në kontekstin e pritjes.

Rezultatet dhe realizimet e synuara

Kjo mbështetje synon të forcojë sistemin e pritjes në vendet e treta partnere, të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të dhëna ndaj azilkërkuesve dhe të sigurojë respektimin e standardeve ndërkombëtare (UNHCR dhe IOM) dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në menaxhimin e pritjes.

Aktivitetet treguese

- Identifikimi i nevojave të trajnimit të stafit të pritjes dhe grupeve të tjera përkatëse të interesit;
- Promovimi i pjesëmarrjes në modulet përkatëse të trajnimit të EUAA-së (p.sh., Sistemi i pritjes dhe pritja e personave të cënueshëm);
- Përkthimi dhe shpërndarja e publikimeve përkatëse të EUAA-së.





Publications Office
of the European Union

